

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXIV, nr. 7897  
E enjte, 3 tetor 2024  
Çmimi 0.50

KMDLNj fton Prokurorinë e Shtetit të bëjë hetime urgjente për situatën e krijuar në FSK | F. 7



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

**AWR** **ABBRUCH** GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

ZYRA E PROKURORIT TË SPECIALIZUAR DERI MË 15 PRILL TË VITIT 2025 DO TË PËRFUNDOJË ME PARAQITJEN E DËSHMITARËVE NË RASTIN E LIDERËVE TË UÇK-së

## PROCESIT GJYQËSOR NDAJ LIDERËVE TË UÇK-së PO I SHIHET FUNDI

FAQE 4-5



Procesi gjyqësor ndaj liderëve të UÇK-së në Hagë është duke shkuar drejt fundit. Zyra e Prokurorit të Specializuar deri më 15 prill të vitit 2025 do të përfundojë paraqitjen e dëshmitarëve në këtë proces

gjyqësor maratonik. Pas kësaj, avokatët e Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit do të kenë mundësi t'i paraqesin para trupit gjykues dëshmitarët e tyre në këtë proces.

Avokati i Thaçit, Luka Misiqi, ka bërë me dije se i duhen gjashtë javë për t'u përgatitur për ta paraqitur rastin e mbrojtjes. Ai ka thënë se nuk planifikon të thërrasë më shumë se 10 dëshmitarë

### AKTUALE



CILAT JANË SFIDAT E KREUT TË RI TË NATO-S MARK RUTTE? F. 3

QEVERIA MAQEDONASE 100 DITË: KRITIKA PËR NGECJEN NË RRUGËN DREJT BE-së F. 2

MINISTRIA VITIA: SË SHPEJTI FERTILIZIMI IN VITRO NË INSTITUCIONET PUBLIKE F. 5

### EKONOMI



SARRAZIN NË PRISHTINË: TREGU RAJONAL DO TË MUNDËSONTE ZHVILLIM F. 8

SBASHK-u: URGJENTISHT TË ZGJIDHET ÇËSHTJA E PAGAVE PËR PUNËTORËT E ARSIMIT NË VITI F. 8

### SPORT



KUKA: DUHET TË JEPET PËRGJEGJËSI PËR MOSREZULTATE F. 10

STEINMEIERI THOTË SE GJERMANIA MBËSHKET ANËTARËSIMIN E KOSOVËS NË BE DHE KIE F. 5



KONJUFCA: RUSIA NUK KA HEQUR DORË NGA 'BOTA RUSE' E AS SERBIA NGA 'BOTA SERBE' F. 5



**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepçisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)  
Mobi: +377 44 501289

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë.  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

# Qeveria maqedonase 100 ditë: Kritika për ngecjen në rrugën drejt BE-së

**SHKUP, 2 TETOR** - Këtë javë Qeveria e Maqedonisë së Veriut, që u krijua nga koalicioni i partive VMRO-DPMNE-VLEN-ZNAM, shënon 100-ditëshin e parë të punës.

Për Qeverinë ato ishin ditë të suksesshme. Porse opozita i konsideron katastrofike - si në planin e brendshëm për shkak të përkeqësimit të raporteve ndëretnike, ashtu dhe në atë të jashtëm, për shkak të moszhbllokimit të procesit të negociatave me Bashkimin Evropian (BE).

Në paraqitjen e tij me rastin e 100 ditëve të Qeverisë, kryeministri maqedonas, Hristijan Mickoski, tha se kabineti qeveritar mbetet i vendosur në rrugën e përbushjes së dy qëllimeve strategjike - mbrojtjen e interesave kombëtare dhe qëndrimin në rrugën drejt BE-së. Ai paralajmëroi reforma të mëdha në drejtësi, luftë kundër krimit dhe korrupsionit, projekte dhe investime të reja, masa dhe vendime me rëndësi të madhe për qytetarët. "Mbase mund të ishin edhe më të suksesshme, por absolutisht nëse dikush do të më pyeste a jam i kënaqur, do të thosha se qind për qind jam i kënaqur me secilin që mori shansin gjatë këtyre 100 ditëve", tha Mickoski.

Ai theksoi se Qeveria e tij "nuk do të bëjë asgjë në kundërshtim me interesat kombëtare dhe orientimet strategjike të qytetarëve", duke aluduar në kontestin me Bullgarinë dhe mosndryshimin e Kushtetutës për përfshirjen e komunitetit bullgar në të.

Sipas tij, për ndryshimin e Kushtetutës, Qeveria e tij "kurrë nuk do të lëshojë pe", për shkak se "ky do të ishte nënçmim dhe turp për qytetarët maqedonas".

Më 25 shtator 2024, ambasadorët e vendeve të BE-së vendosën njëzëri për nisjen e negociatave me Shqipërinë për anëtarësim në bllokun evropian, duke e ndarë atë nga Maqedonia e Veriut, e cila nuk arriti të përbushë kushtin për ndryshimin e Kushtetutës. Ndryshimet kushtetuese parashohin përfshirjen e bullgarëve si popull shtetformues, për të vazhduar procesin e integritimit evropian dhe për të hapur negociatat me Komisionin Evropian.

Një nga premtimet kryesore parazgjedhore të VMRO DPMNE-së ishte përparimi në procesin e integritimit evropian dhe anëtarësimi i plotë në BE. Ndërkohë, partneri i tyre i koalicionit, koalicioni shqiptar VLEN, kishte vendosur një afat gjashtëmujor në programin e tij për përbushjen e kushtit që do

të mundësonte fillimin e negociatave me BE-në.

Lidhur me 100-ditëshin e punës së Qeverisë, më 29 shtator 2024, koalicioni VLEN, veçmas nga partneri qeveritar VMRO-DPMNE, u lavdërua me arritjet e veta.

Zëvendëskryeministri i parë, Izet Mexhiti, njëkohësisht edhe lider i Lëvizjes Demokratike (LD), si sukses përmendi disa projekte, duke përfshirë luftën kundër biznesit të kazinove, për ç'gjë, sipas tij, tashmë kanë nisur procedurat. "Angazhimi ynë është të vazhdojmë me përkushtim deri në eliminimin e plotë të këtyre aktiviteteve që shkatërrojnë jetën sociale dhe ekonomike të mijëra familjeve",



## Çfarë thonë qytetarët?

Viktoria Ristovska, qytetare nga Tetova, mendon se periudha e 100-ditëshit të parë nuk mjafton për të dhënë një vlerësim të plotë. Megjithatë, sipas saj, Qeveria nuk ka treguar deri tani rezultate konkrete. "Sinçerisht, nuk di çfarë të them. Mendimet i kam të përziera. Edhe pse Qeveria e re, si çdo qeveri, që premton në fillim dhe na tregon ambicie për reforma të reja, mendoj se rezultatet janë ende larg premtimeve që morëm. Ngecja e Maqedonisë së Veriut në rrugën drejt Bashkimit Evropian është një dështim dhe mendoj se mosmarrëveshjet që kemi si shtet, me fqinjët tanë, e bllokajnë rrugën që vendi ynë të anëtarësohet në BE", thotë Ristovska për Radion Evropa e Lirë. Në të njëjtën linjë me të është edhe Albërie Xhemaili nga Kumanova. Edhe ajo thotë se është herët për një vlerësim të qëndrueshëm, por vëren se

tha ai.

Pavarësisht optimizmit të Qeverisë, partia opozitare Lidhja Socialdemokrate e Maqedonisë, e ka pritur 100-ditëshin e parë të saj me sloganin "100 ditë arsytetime, skandale dhe dëshpërime". "Deri tani, nuk ka pasur një Qeveri me një fillim kaq të keq të sundimit. Nëse dita shihet nga mëngjesi, edhe më keq i pret qytetarët dhe shtetin me Mickoskin dhe VMRO DPMNE-në. Kjo është Qeveria më e paafte që nga pavarësia e shtetit e deri më sot", thanë nga kjo parti.

Edhe Bashkimi Demokratik për Integritim (BDI), parti shqiptare

niveli i përfaqësimit politik të shqiptarëve ka rënë ndjeshëm. Një tjetër këndvështrim ka Omer Demiri nga Shqipëria, i cili studion në Maqedoninë e Veriut: "Më shqetëson fakti se Maqedonia e Veriut ka mbetur prapa në rrugën drejt integritimit në Bashkimin Evropian, ndërkohë që Shqipëria po vazhdon përpara, kur në fakt rrugëtimin e kanë filluar të dyja bashkë. Ky dallim në ecurinë evropiane midis dy vendeve fqinje ngjall pyetje serioze mbi prioritetet e politikave të brendshme të Maqedonisë (së Veriut) dhe angazhimin e saj për reformat që kërkohen nga BE-ja. Por, mendoj se ka pasur edhe hapa pozitivë, shembull një shok më tha se ka filluar një lloje fushate për mbylljen e kazinove online. Mendoj se ka përparime, por është e qartë se ka ende shumë punë për të bërë që të përbushen pritjet e qytetarëve".

në opozitë, e vlerësoi me nota negative 100-ditëshin e koalicionit qeverisës, duke e goditur sidomos partnerin shqiptar të koalicionit, grupimin VLEN. "Vendimi i Bashkimit Evropian që ta ndajë Shqipërinë nga Maqedonia e Veriut në rrugëtimin tonë evropian, është dështim shekullor për Qeverinë me legjitimitet monoetnik", thanë nëpërmjet një komunikatë për media nga BDI-ja, duke kërkuar kthim të menjëhershëm të prioritetit shtetëror për integritim evropian dhe distancim të menjëhershëm të Qeverisë nga partneriteti ruso-kinez.

## Por, a janë njëqind ditë të mjaftueshme për t'i vlerësuar punët e Qeverisë?

"Mendoj se 100 ditë janë një periudhë e shkurtër për të dhënë një vlerësim të saktë për performancën e kësaj qeverie, apo të çdo qeverie tjetër", thotë në një prononcim për Radion Evropa e Lirë analisti politik, Xhelal Neziri.

Sipas tij, tremujori i parë i Qeverisë maqedonase është periudha kur duhet të respektohet vullneti i shumicës, i dhënë në zgjedhje të drejtpërdrejta. "Besoj se kjo periudhë i është dhënë. Sa është shfrytëzuar kjo periudhë nga ana e Qeverisë, për të bërë apo për të nisur reforma radikale, besoj se është bërë shumë pak", konsideron ai.

Neziri vlerëson se gjatë kësaj periudhe, Qeveria ka qenë e pakoordinuar për të bërë reforma, siç i quan ai "radikale". "Zakonisht, kjo periudhë shfrytëzohet nga çdo qeveri. Fillimi i mandatit shfrytëzohet për të bërë reforma të mëdha radikale, për të marrë vendime të mëdha ose për të bërë marrëveshje që janë të dhimbshme në rrethana normale politike. Mendoj se në këtë periudhë, kjo Qeveri nuk ka arritur t'i bëjë këto kthesa të mëdha; nuk arriti t'i miratojë ndryshimet kushtetuese, edhe pse fillimi i mandatit do të ishte një kohë e përshtatshme për t'i bërë ato, sepse nuk do të shkaktonte edhe aq shumë dëme politike për vetë partitë që përbëjnë koalicionin qeverisës", vlerëson Neziri.

Ai shton se, përveç premtimeve për reforma në administratë, të cilat përfunduan si antireforma me miratimin e Ligjit për

riorganizimin e saj, ku numri i ministrive u rrit nga 16 në 20, Qeveria nuk arriti të përbushë edhe shtyllën kryesore të programit të saj parazgjedhor - luftën kundër korrupsionit. "Pas gjithë atyre akuzave për funksionarë të korruptuar nga Qeveria e kaluar, megjithatë nuk pamë se ka ndonjë hetim serioz lidhur me ato indicie. Po ashtu, shkaktoi probleme të panevojshme edhe me fqinjët, me vetë faktin se nuk respektoi Kushtetutën e re të vendit, që do të thotë përdorimin e emrit të ri kushtetues (Maqedonia e Veriut) për përdorim të përgjithshëm, dhe me këtë shkaktoi problem edhe me Greqinë", thotë Neziri, duke përmendur edhe një përkeqësim marrëdhëniesh me Bullgarinë. "Pra, kemi një funksionim të Qeverisë që është në kundërshtim me ato tri shtyllat e programit të saj, të cilat janë: integritimi në Bashkimin Evropian, zhvillimi ekonomik dhe lufta kundër korrupsionit", shpjegon Neziri duke nënvizuar se nëse duhet të vlerësohet ndonjë arritje gjatë këtij 100-ditëshi, kredia e marrë prej gjysmë miliard eurosh nga Hungaria, "mund të jetë një infuzion i rëndësishëm për vendin".

Kryeministri Hristijan Mickoski gjatë fushatës parazgjedhore kishte premtuar marrjen e borxhit prej një vendi të huaj, por nuk kishte treguar se për cilin shtet bëhet fjalë. Ai kishte paralajmëruar nismën e re për zhvillimin e komunave në Maqedoninë e Veriut duke siguruar 250 milionë euro. Kurse, pjesa tjetër e huas prej 250 milionësh, është e destinuar për zhvillimin e bizneseve.

Kushtet, sipas të cilave shteti e merr huan nga Hungaria, janë me një kamatë vjetore prej 3.25 për qind, një periudhë "grejs" trevjeçare dhe 12 vjet për shlyerjen e kredisë. /REL

# Cilat janë sfidat e kreut të ri të NATO-s Mark Rutte?

*Kreu i ri i NATO-s, Mark Rutte, merr sot detyrën si kreu i ri i NATO-s. Në këto kohë plot sfida atij do t'i duhen të gjitha aftësitë diplomatike për ta menaxhuar aleancën veriperëndimore. Por cila janë këto sfida?*



**Bernd RIEGERT,**  
Korrespondent nga Brukseli,  
me fokus te njerëzit, ngjarjet dhe  
politikat në BE

Mark Rutte njoftoi në korrik 2023 se ka dhënë dorëheqje si kryeministër i Holandës dhe "është tërhequr nga politika" pasi koalicioni i tij qeveritar u rrëzua nga pushteti për shkak të dallimeve mes partive në pushtet për politikën e migracionit. Megjithatë, në tetor të vitit të kaluar, Rutte, me sa duket, kishte harruar gjithçka që tha për largimin e tij nga politika dhe shprehu dëshirën për ta pasuar Sekretarin e Përgjithshëm të NATO-s, Jens Stoltenberg, i cili kishte njoftuar se do të largohej përfundimisht nga posti në fund të shtatorit të vitit 2024 pas një dekade në krye të aleancës.

Për muaj të tërë, Rutte zhvilloi një fushatë diskrete për të fituar mbi udhëheqësit e NATO-s, shumicën e të cilëve ai i njihje tashmë prej më shumë se 13 vitesh si kryeministër holandez dhe nga puna me organizma të ndryshëm ndërkombëtarë. Historiani ishte kandidati i favorizuar i presidentit amerikan Joe Biden, si edhe i shumicës së liderëve evropianë.

Një diplomat i tha DW-së se Rutte shihet si "Mr. No" në Bashkimin Evropian, sepse ai ka refuzuar planet dhe idetë ambicioze të reformës të

paraqitura nga presidenti francez Emmanuel Macron. Megjithatë, Rutte ka raporte të mira me kancelarin gjerman Olaf Scholz. Ai është, gjithashtu, në marrëdhënie të mira me kryeministren populiste të krahut të djathtë të Italisë, Giorgia Meloni. Së bashku, Rutte dhe Meloni kanë sugjeruar përpunimin e kërkesave për azil jashtë BE-së në shtetet e palëve të treta.

## Rezistenca e Hungarisë

Por fitorja ndaj kryeministrit nacionalist të krahut të djathtë të Hungarisë, Viktor Orban, me të cilin ai nuk është në marrëdhënie të mira, zgjati pak. Rutte duhej t'i premtojte Orbanit se Hungaria nuk duhet të marrë pjesë në aktivitetet që mbështesin Ukrainën, për sa kohë që Rutte drejton aleancën. Orban, i cili mban lidhje miqësore me Rusinë, ka përrjashtuar edhe dërgesat e armëve në Ukrainë.

Politika liberale e Rutte dhe këndvështrimi joliberal i Orbanit shpesh i vendosin ata në mosmarrëveshje në marrëdhënie të tyre brenda BE-së. Kur Hungaria miratoi një ligj kundër LGBTQ+ në 2021, Rutte i tha Orbanit se mund të largohet nga blloku nëse nuk pajtohet me politikën e tij.

Aftësia e famshme e Rutte për të përballuar vështirësitë politike i

ka dhënë atij pseudonimin "Teflon Mark", e kjo mund të jetë e dobishme nëse Donald Trump kthehet në Shtëpinë e Bardhë dhe vendos të kritikojë prapë NATO-n. Pavarësisht nga kjo tendencë, Rutte dhe Trump zhvilluan raporte çuditërisht pozitive gjatë mandatit të parë të Trumpit si president i SHBA-së. Trump e quajti Rutte madje një "mik". Por Rutte, si udhëheqës i një kombi historik tregtar, kundërshtoi ashpër politikën ekonomike proteksioniste të Trumpit.

## Rutte mbështet armatosjen e Ukrainës

Ndryshe nga Trump, Rutte është një mbështetës i vendosur i Ukrainës dhe ka kërkuar dërgesa të mëdha të armëve në Kiev, duke përfshirë obuset holandeze dhe F-16. Por vetë ushtria holandeze nuk ishte e financuar sa duhet gjatë viteve të pushtetit të Rutte. Ky vit do të jetë hera e parë që Holanda do të shpenzojë 2% të

PB-së së saj në mbrojtje, në përputhje me objektivat e shpenzimeve të NATO-s.

Rutte ka qenë prej kohësh kritik ndaj presidentit rus Vladimir Putin, jo vetëm sepse Rusia shihet gjerësisht si pjesërisht përgjegjëse për rrëzimin e avionit MH-17 mbi Ukrainën lindore në vitin 2014. Pothuajse 300 njerëz, shumica prej të cilëve shtetas holandezë, vdiqën kur avioni i Malaysia Airlines, që udhëtonte nga Amsterdami për në Kuala Lumpur, u rrëzua. Hetuesit ndërkombëtarë arritën në përfundimin se raketa që goditi avionin ishte e prodhuar në Rusi dhe ishte lëshuar nga territori i pushtuar nga separatistët në Ukrainën lindore.

## Krijimi i konsensusit

Rutte ka përvorë në menaxhimin e koalicioneve në Holandë, por tani ai ka 32 vende që duhet të koordinojë dhe me të cilat duhet të arrijë konsensus për të gjitha vendimet e NATO-s. Ish-

zdhënësjka e NATO-s, Oana Lungescu, personi më jetëgjatë në këtë rol, beson se kjo do të jetë sfida më e madhe e Rutte. "Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s nuk duhet të jetë vetëm sekretar, por edhe gjeneral, në aspektin politik natyrisht", tha ajo për DW. "Ai duhet të tregojë udhëheqjen politike të nevojshme për të shtyrë përpara aleancën, sepse arritja e konsensusit mund të marrë kohë. Mund të ketë probleme, mund të jetë zhgënjuese, por është e rëndësishme të arrihet përparim në marrjen e vendimeve". Ajo thekson se përvoja e gjatë e Rutte në mbajtjen së bashku të qeverive të koalicionit holandez të përçarë do t'i shërbejë atij për të ecur përpara.

Lungescu vëren se të qenit shef i NATO-s do të thotë t'u nënshtrohesh edhe disa nevojave të pashmangshme të pozicionit dhe profilit të lartë, që do të thotë se Rutte nuk mund të shkojë më në punë me biçikletë dhe duhet të ndryshojë sjelljet.

## Kurti takon ministrin e Mbrojtjes së Estonisë, flasin për bashkëpunim në fushën e mbrojtjes



**PRISHTINË, 2 TETOR** - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, së bashku me ministrin e Mbrojtjes, Ejup Maqedonci, ditën e dytë të pjesëmarrjes në Forumin e Varshavës për Siguri e filloi me takimin bilateral me ministrin e Mbrojtjes së Estonisë, Hanno Pevkur. "Republika e Kosovës dhe Estonia kanë marrëdhënie të shkëlqyeshme dypalëshe, të cilat kryeministri Kurti dhe ministri Pevkur në këtë takim shprehën vullnetin dhe gatishmërinë për t'i zgjeruar edhe më tutje", thuhet në njoftimin e Kryeministrit. Kryeministria njofton se krahas bashkëpunimit në fushën e

digitalizimit dhe sigurisë kibernetike, ku Kosova po përfiton nga përvojat dhe ekspertiza e Estonisë, gjatë bashkëbisedimit sot u diskutua rreth mundësive për bashkëpunim në fushën e mbrojtjes. Kryeministri Kurti theksoi se mbështetja e Estonisë është shumë e rëndësishme për forcimin e kapaciteteve mbrojtëse të Kosovës dhe rolin e saj kontribues në stabilitetin e rajonit.

Sipas njoftimit, kryeministri Kurti falënderoi ministrin Pevkur për mbështetjen e vazhdueshme të Estonisë ndaj Kosovës në rrugëtimin e saj integruar në Bashkimin Evropian.



ZYRA E PROKURORIT TË SPECIALIZUAR DERI MË 15 PRILL TË VITIT 2025 DO TA PËRFUNDOJË PARAQITJEN E DËSHMITARËVE NË RASTIN E LIDERËVE TË UÇK-SË

## Procesit gjyqësor ndaj liderëve të UÇK-së po i shihet fundi

Procesi gjyqësor ndaj liderëve të UÇK-së në Hagë është duke shkuar drejt fundit. Zyra e Prokurorit të Specializuar deri më 15 prill të vitit 2025 do të përfundojë paraqitjen e dëshmitarëve në këtë proces gjyqësor maratonik. Pas kësaj, avokatët e Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit do të kenë mundësi t'i paraqesin para trupit gjykues dëshmitarët e tyre në këtë proces. Avokati i Thaçit, Luka Misetiq, ka bërë me dije se i duhen gjashtë javë për t'u përgatitur për ta paraqitur rastin e mbrojtjes. Ai ka thënë se nuk planifikon të thërrasë më shumë se 10 dëshmitarë

se nuk planifikon të thërrasë më shumë se 10 dëshmitarë. "Nuk kemi vendosur ende se do të thërrasim dëshmitarë. Por, jo më shumë se dhjetë, me kushtin që ky parashikim mund të ndryshohet", ka thënë Misetiq.

Më tutje, kryegjyqtari Charles Smith ka pasur kritika për mungesën e efektivitetit në shfrytëzimin e kohës duke kritikuar më së shumti mbrojtjen.

Fillimisht, Prokuroria e Hagës kishte bërë me dije se synon të ketë 312 dëshmitarë. Megjithatë, një pjese të tyre iu pranuan dëshmitë me shkrim e disa u larguan tërësisht. Megjithatë, sipas prokurorisë, numri i dëshmitarëve do të ulet edhe më tutje, në mënyrë që në prill të përfundojë rasti i Prokurorisë së Specializuar e të fillojnë dëshmitarët e mbrojtjes.

Prokuroria e Hagës tash ka larguar nga lista e dëshmitarëve edhe 11 persona, kurse dëshmitë e shtatë dëshmitarëve të tjerë do të pranohen me shkrim. "Prokuroria e Specializuar nuk synon më të mbështetet në dëshmitë e njëmbëdhjetë (11) dëshmitarëve në vijim: [redaktuar]. Përveç kësaj, PSP-

ja synon t'i dorëzojë me shkrim dëshmitë e shtatë (7) dëshmitarëve të mëposhtëm, në vend që t'i thërrasë ata për të dëshmuar", është thënë në njoftim.

Prokuroria e Hagës është zotuar se do të vazhdojë edhe më tutje ta shkurtojë listën e dëshmitarëve, duke synuar që rastin e saj ta përfundojë në prill të vitit 2025. "Prokuroria e Specializuar do të vazhdojë të shqyrtojë dhe, sipas rastit, të rregullojë paraqitjen e rastit. Në mënyrë të veçantë, duke marrë parasysh ndër të tjera dëshmitarët e ardhshëm (dhe duke iu nënshtruar vendimeve për mocionet e provave), parashikohet që ZPS të jetë në gjendje të njoftojë të paktën shtatë ndryshime shtesë në listën e saj të dëshmitarëve më 1 nëntor 2024", është thënë në njoftim.

Liderët e UÇK-së, Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi dhe Jakup Krasniqi, janë duke u mbajtur në paraburgim në Hagë që na fillimi i muajit nëntor të vitit 2020. Procesi gjyqësor ndaj tyre ka filluar më 3 prill të vitit 2023. Ata janë deklaruar të pafajshëm në raport me akuzat me të cilat i ka ngarkuar Zyra e Prokurorit të Specializuar në Hagë.

EPOKA E RE

Lirim GECI

**HAGË, 2 TETOR** - Gjykimi në rastin e liderëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit, është duke shkuar drejt fundit. Të paktën, për dëshmitarët dhe provat e Zyrës së Prokurorit të Specializuar (ZPS) të cilat pritet të përmbillen më së largu deri më 15 prill 2025. Kështu ka bërë me dije Zyra e Prokurorit të Specializuar në konferencën për ecurinë e çështjes.

Prokurori Matt Hawling ka bërë me dije se kanë planifikuar të ftojë edhe 65 dëshmitarë në sallën e gjykimit, megjithatë, mund të largohen edhe 7 dëshmitarë. Ai është shprehur se mund ta përfundojë rastin e tyre deri në prill 2025, ashtu siç

u është përcaktuar nga trupi gjykues. "Ne po përpiqemi ta përmbushim datën e synuar të paraqitjes së provave nga Prokuroria", ka thënë ai.

Ndërsa kryegjyqtari Charles Smith ka pasur kritika që nuk po ka dëshmitarë rezervë për ta vazhduar sa më shpejt përfundimin e dëshmitëve. Ai ka thënë se nuk e kanë ndër mend ta zgjasin afatin për paraqitjen e rastit të ZPS-së. "Nuk parashikohet nga trupi gjykues që do të zgjasim ditën e synuar për përfundimin e provave nga Prokuroria. Përderisa ky është synimi ynë, është më vlerë dhe e zgjuar nga Prokuroria t'i paraqesë dëshmitarët më të rëndësishëm", ka thënë ai.

Ligjërish, pas paraqitjes së rastit nga ZPS-ja, avokatët kanë të drejtë ta kërkojnë hedhjen e aktakuzës.

**Avokati i Thaçit i bindur në fitore: Nuk kemi vendosur ende nëse do të thërrasim dëshmitarë, por nëse do të thërrasim, jo më shumë se dhjetë**

Ndërsa avokatët e liderëve të UÇK-së kanë bërë me dije se synojnë ta shfrytëzojnë këtë mundësi, megjithatë afati është i shkurtër. "Do të kërkojmë të paktën 1 muaj kohë për ta bërë kërkesën tonë", ka thënë avokati i Jakup Krasniqit.

Kurse avokati i Hashim Thaçit, Luka Misetiq, ka bërë me dije se do t'i duhen gjashtë javë për t'u përgatitur për ta paraqitur rastin e mbrojtjes. Ai ka thënë

# Steinmeieri thotë se Gjermania mbështet anëtarësimin e Kosovës në BE dhe KiE

Pas vizitës zyrtare në vitin 2021, dhe një sërë takimesh pune e telefonatash, të mërkurën presidentja Vjosa Osmani është prituri sërish në takim pune në Pallatin Bellevue në Berlin nga presidenti i Republikës Federale të Gjermanisë, Frank-Walter Steinmeier. Ajo është shprehur falënderuese për mbështetjen e vazhdueshme të presidentit Steinmeier për integrimin e Kosovës në institucionet euroatlantike si dhe për diskutimet e rëndësishme për rrugën përpara



cila është urë e fuqishme për raportet ndërmjet dy shteteve. Të dy presidentët diskutuan edhe për potencialin për zgjerimin e bashkëpunimit në fusha të interesit të dyanshëm.

Presidenti i Gjermanisë, Frank-Walter Steinmeier, ka thënë se vendi i tij e mbështet anëtarësimin e Kosovës në Bashkimin Evropian dhe në Këshillin e Evropës dhe se është i interesuar për stabilitet në rajon, pas një takimi me presidenten e Kosovës, Vjosa Osmani, të mërkurën në Berlin.

Në një shkrim në "Facebook", Steinmeier tha se Kosova "duhet të punojë për të krijuar kushte të nevojshme për këtë".

Kosova aplikoi për anëtarësim në BE në dhjetor të vitit 2022, por ende nuk e ka marrë statusin e vendit kandidat. Ndërkohë, ajo dështoi të anëtarësohet në Këshillin e Evropës në fillim të këtij viti për shkak se u kushtëzua me themelimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe në Kosovë.

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

**BERLIN, 2 TETOR** - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, në ditën e dytë të vizitës së punës në Gjermani, ka takuar presidentin e Republikës Federale të Gjermanisë, Frank-Walter Steinmeier.

Diskusimet u fokusuan në thellimin e marrëdhënieve dypalëshe, zhvillimet aktuale në Kosovë dhe në Ballkanin Perëndimor si dhe avancimin e

integritet të Kosovës në organizatat ndërkombëtare.

Presidentja Osmani shprehu vlerësimin e thellë për mbështetjen e Gjermanisë për Kosovën në procesin e lirisë dhe shtetndërtimit, por edhe në rrugën euroatlantike. "Kosova dhe Gjermania kanë një partneritet të fortë dhe të qëndrueshëm të bazuar në vlerat e përbashkëta të demokracisë, paqes dhe progresit. Gjermania është aleate strategjike në rrugëtimin e Kosovës drejt fuqizimit dhe integritetit

ndërkombëtar, ndaj presim ta forcojmë edhe më tej këtë partneritet në vitet në vijim", ka theksuar Osmani.

Procesin e Berlinit, presidentja Osmani e ka cilësuar shtytësë e fuqishme për perspektivën evropiane të Ballkanit Perëndimor.

Në këtë kontekst, presidentja Osmani ka ritheksuar mbështetjen e plotë për marrëveshjet e dala nga ky proces.

Në takim me presidentin Steinmeier, presidentja Osmani ka potencuar rolin dhe kontributin e mërgatës shqiptare në Gjermani, e

# Konjufca: Rusia nuk ka hequr dorë nga 'bota ruse' e as Serbia nga 'bota serbe'

EPOKA  
ERE

Mal QORRAJ

**PRISHTINË, 2 TETOR** - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, mori pjesë dhe mbajti fjalim në konferencën "Impakti i agresionit rus në Rusi dhe në gjeopolitikën evropiane", organizuar të mërkurën në Prishtinë nga Instituti për Studime të Luftës Hibride, OCTOPUS.

Në adresimin e tij para të pranishmëve, Konjufca tha se pasojat e agresionit rus në Ukrainë kanë ndikuar kontinentin evropian, paqen, stabilitetin, sigurinë, politikën dhe gjeopolitikën e tij, më shumë se çdo konflikt tjetër që prej Luftës së Dytë Botërore.

Kreu i Kuvendit tha se për shkak të mosdhënies së një përgjigjeje të vendosur në vitin 2014 ndaj pushtimit rus të Krimesë, Evropa sot po ballafaqohet me një luftë e cila nuk ka të bëjë vetëm me fatin e Ukrainës si shtet sovran dhe me dinjitetin e ukrainasve si komb, por kjo luftë përbën edhe një betejë vendimtare për rendin demokratik në Evropë, të ndërtuar pas rënies së



"Perdes së Hekurt" më 1989. "Në kontekstin tonë rajonal dhe ballkanik, agresioni pushtues i Rusisë në Ukrainë paraqet aktin e parë të një strategjie destabiliteti të Evropës, ku natyrisht Ballkani, me Serbinë si një zgjatim të Rusisë, do të ishte akti i dytë i kësaj strategjie. As Rusia e as Serbia nuk kanë hequr dorë nga kjo strategji, sepse as Rusia nuk ka hequr dorë nga 'bota ruse', e as Serbia nuk ka hequr

dorë nga 'bota serbe'. Sulmi terrorist ndaj Kosovës në Banjskë shtatorin e vitit të kaluar ishte një replikë identike e sjelljes agresore të Rusisë ndaj Ukrainës. Trupa paramilitare serbe, të trajnuara nga ushtria serbe, të pajisura me arsenal luftarak të Ministrisë serbe të Mbrojtjes, si dhe në zbatim të aspiratës së Beogradit për ndarjen e Kosovës, synuan aneksimin e veriut, me ç'rast në mbrojtje të

sovranitetit, integritetit dhe sigurisë së Republikës së Kosovës u vra oficeri i Policisë së Kosovës, tashmë heroji Afrim Bunjaku", tha kryetari Konjufca.

Në vazhdim të fjalës së tij, kreu i Kuvendit të Kosovës tha se dualizmi është armë e njohur e Serbisë në arenën ndërkombëtare për realizimin e interesave të veta, por po aq i njohur është edhe fakti që Serbia kurrë në historinë e saj nuk ka qenë një kështjellë ku është mbrojtur Perëndimi, sepse pas çdo lufte Serbia gjithnjë është rreshtuar kah Lindja. Pra, në këtë luftë të Ukrainës në mbrojtje të sovranitetit të vet, shtoi kryetari Konjufca, Serbia nuk është aleate e saj, por thjesht po përfiton duke bërë biznes e duke shitur armë. "Përpjekja për destabilizimin e Bosnjës përmes Dodikut që promovon çdo ditë shpëputjen e Republikës Srpska dhe bashkimin e saj me 'botën serbe', refuzimi i normalizimit të marrëdhënieve me Kosovën përmes njohjes faktike që kornizon Marrëveshja e Brukselit dhe përpjekja për

ndryshimin e orientimit euroatlantik të Malit të Zi, janë gjurmë konkrete të një politike që synon të minojë çdo progres që investimi europerëndimor ka pasur në rajonin tonë", ka pohuar Konjufca, duke shtuar se, siç lufta në Ukrainë është edhe luftë e Evropës në mbrojtje të rendit të saj demokratik, edhe stabiliteti i Ballkanit Perëndimor do të varet se sa ai do të ndërtohet, mbi parimet demokratike dhe europeanizuese apo mbi interesa parciais ekonomike.

Kryetari i Kuvendit të Kosovës tha se në rajonin tonë nuk do të ketë stabilitet pa u arritur stabilizimi i demokracisë në secilin prej shteteve, në veçanti kjo nënkupton pa heqjen dorë të Serbisë prej aspiratave të saj hegjemoniste, të cilat prekin pavarësinë dhe sovranitetin e të paktën tri shteteve të saj fqinje. "Nuk mund të ketë unitet pa barazi, sikurse nuk ka garanci për liri e pa demokraci. Mendoj që këto janë fundamentet për të cilat sot Perëndimi po mbështet në Ukrainë dhe duhet t'i mbështesë edhe në Ballkan", tha kryeparlamentari Konjufca.

## Ministria Vitia: Së shpejti fertilizimi in vitro në institucionet publike

**PRISHTINË, 2 TETOR** - Ministri i Shëndetësisë, Arben Vitia, ka bërë me dije se ka nënshkruar përditësimin më të ri të Listës të Produkteve Mjekësore, në të cilin janë futur produktet e nevojshme për procedurën e fertilizimit in-vitro sipas protokolleve referente. Ai ka

thënë se këto produkte së shpejti do të sigurohen falas për qytetarët nga shteti. "Deri më tani për të njëjtat produkte qytetarët tanë kanë shpenzuar 1 000 - 1 500 euro në sektorin privat. Një falënderim i veçantë për Klinikën e Gjinekologjisë, Shërbimin Spitalor dhe Klinik

Universitar të Kosovës, Barnatoren Qendrore të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës, Komitetin Kyç për angazhimin profesional që këto produkte të futen në Listën e Produkteve Mjekësore. Futja e këtyre produkteve në Listën e Produkteve Mjekësore është

parakusht për të ofruar shërbimin e fertilizimit in-vitro për të cilin qytetarët tanë deri më tani kanë shpenzuar mijëra euro. Së shpejti kjo procedurë do të mund të realizohet në institucionet publike shëndetësore", ka thënë ministri Vitia.



# Kryeministri i Shqipërisë në fjalimin e tij në Asamblenë e Përgjithshme të OKB-së: Kosova nuk duhet të mbetet peng i interesave politike të disa subjekte ndërkombëtare



Shkruan:  
Prof. Dr. Fejzulla  
BERISHA

Në një fjalim të detajuar mbi çështjen e Kosovës, kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ka trajtuar pika kyçe që lidhen me njohjen ndërkombëtare të Kosovës dhe përparimin e saj drejt integritimit në strukturat evropiane dhe ndërkombëtare. Ai ka bërë thirrje të drejtpërdrejtë ndaj pesë vendeve të Bashkimit Evropian që ende nuk e kanë njohur Kosovën (Spanja, Greqia, Rumania, Sllovakia dhe Qipro), duke theksuar se mosnjohja e tyre përbën një pengesë të madhe për stabilitetin rajonal dhe për integritimin e plotë të Ballkanit Perëndimor në BE.

Çështja e njohjes nga pesë vendet e BE-së: Rama theksoi se pesë vendet e BE-së që nuk e kanë njohur Kosovën po bllokojnë përparimin e saj dhe po pengojnë vendosjen e saj si anëtare e barabartë në komunitetin evropian. Ai e konsideroi paradoksale që një pjesë e BE-së të mos njohë një realitet që është njohur nga mbi 100 vende, përfshirë shumicën dërrmuese të anëtarëve të Bashkimit Evropian. Rama nënvizoi se disa vende, si Spanja dhe Qipro, e lidhin mosnjohjen e Kosovës me çështje të brendshme të tyre, si lëvizjet separatiste apo konfliktet territoriale. Ai apeloj që këto vende të distancojnë çështjet e tyre të brendshme nga procesi i njohjes së Kosovës dhe të veprojnë në përputhje me

parimet e së drejtës ndërkombëtare dhe stabilitetit rajonal.

Kritika ndaj Bashkimit Evropian: Rama kritikoi hapur Bashkimin Evropian për mungesën e unitetit në qëndrimet ndaj Kosovës. Ai theksoi se një BE e ndarë në këtë çështje është e padrejtë ndaj Kosovës dhe minon besueshmërinë e vetë BE-së si një organizatë që përfaqëson vlerat e unitetit dhe paqes. Rama argumentoi se njohja e Kosovës nga të gjitha vendet e BE-së është thelbësore, jo vetëm për të ardhmen e Kosovës, por edhe për forcimin e Bashkimit Evropian. Mosnjohja e Kosovës, sipas tij, pengon zgjerimin e BE-së në

Ballkanin Perëndimor dhe krijon një vakum që mund të shfrytëzohet nga aktorë të tjerë si Rusia dhe Kina, të cilët synojnë të rrisin ndikimin e tyre në rajon.


Rëndësia e dialogut mes Kosovës dhe Serbisë: Një pikë tjetër qendrore e fjalimit të Ramës ishte nevoja për vazhdimin e dialogut mes Kosovës dhe Serbisë. Ai theksoi se dialogu i ndërmjetësuar nga BE-ja është rruga e vetme drejt një zgjidhjeje të qëndrueshme dhe normalizimit të marrëdhënieve mes dy vendeve. Rama shprehu mbështetjen e plotë të Shqipërisë për procesin e dialogut dhe bëri thirrje për një përqendrim më të madh nga ana e bashkësisë ndërkombëtare. Një marrëveshje

përfundimtare mes Kosovës dhe Serbisë, sipas Ramës, do të ishte një faktor kyç për stabilitetin në Ballkanin Perëndimor.

Mbështetja e Shqipërisë për Kosovën: Rama theksoi se Shqipëria do të mbetet një mbështetëse e palëkundur e Kosovës në arenën ndërkombëtare. Ai nënvizoi se pavarësia dhe integriteti territorial i Kosovës janë të pacenueshme dhe se Shqipëria do të bëjë gjithçka të mundur për të promovuar njohjen ndërkombëtare të saj dhe për të mbrojtur interesat e Kosovës në forumet ndërkombëtare. Rama shtoi se bashkëpunimi i ngushtë mes Shqipërisë dhe Kosovës është

thelbësor për avancimin e interesave të përbashkëta dhe zhvillimin ekonomik, social dhe kulturor të të dyja vendeve.

Apeli për unitet evropian: Kryeministri Rama apeloj për një Evropë më të bashkuar dhe koherente në qëndrimet e saj. Ai theksoi se BE-ja duhet të veprojë si një bllok i unifikuar, pasi qëndrimet e ndara jo vetëm që dëmtojnë çështjen e Kosovës, por gjithashtu zbehin rolin e BE-së si një faktor stabiliteti në botë. Njohja e Kosovës nga të gjitha vendet e BE-së, sipas Ramës, do të forconte paqen dhe stabilitetin dhe se Kosova nuk mundet të mbetet peng i interesave politike të disa subjekteve ndërkombëtare.



## Rektori Arben Hajrullahu shkon në Berlin për arsimin e së ardhmes



PRISHINE, 2 TETOR - Edicioni i tetë i konferencës dyditore të Shtyllës për Shkencë, Arsim, Hulumtim e Inovacion të Procesit të Berlinit mbledhi në kryeqendrën gjermane përfaqësues të jetës akademike dhe universitare nga gjashtë shtetet e Ballkanit Perëndimor dhe vendet e Bashkimit Evropian. Në konferencën vjetore që sivjet pati moton "Guximi për të Ardhmen", Universitetin e Prishtinës e përfaqësoi rektori i tij Arben Hajrullahu. Gjatë dy ditëve sa zgjati ky aktivitet, po diskutohet rreth Programit Komizë për

Hulumtim dhe Inovacion të BE-së (FP 10) që pritet të hyjë në fuqi në janar të vitit 2028, ndërsa synon unifikimin e mënyrës se si do të zhvillohet dhe financohet shkencën, kërkimi shkencor dhe shpikjet në Evropë përballë sfidave dhe krizave globale. "FP 10" është vazhdimësi e programit "Horizont" nga i cili përfitoi edhe Universiteti i Prishtinës. Në konferencë u fol edhe për idenë evropiane për Ballkanin, nxitjen dhe forcimin e demokracisë dhe u rishikuan dhjetë vjetët e Procesit të Berlinit, një platforme e themeluar në

vitin 2014 me qëllim të rritjes së bashkëpunimit mes gjashtë shteteve të Evropës Juglindore, Gjermanisë dhe Bashkimit Evropian. Vitin e kaluar kjo konferencë kishte në qendër partneritetin e pjesës tjetër të Evropës me shtetet ballkanike. Universiteti i Prishtinës bashkëpunon me Akademinë Kombëtare Gjermane të Shkencave "Leopoldina", organizatoren e kësaj konference dhe koordinatoren e Procesit të Berlinit në fushën e arsimit, shkencës dhe inovacionit.

## KMDLNj fton Prokurorinë e Shtetit të bëjë hetime urgjente për situatën e krijuar në FSK

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 2 TETOR - Tema e ushqimit të ushtarëve të Forcës së Sigurisë ka ngjallur reagime të mëdha në opinion. Të martën Ministria e Mbrojtjes ka dalë me një reagim, ku ka sqaruar se ushqimi për ushtarët mbetet i njëjti siç ishte i kaluari, veçse kuzhinierët janë huazuar nga Qendra e Studentëve dhe Shërbimi Korrektues.

Meqenëse aktualisht tenderi për furnizim me ushqim nuk është nënshkruar nga Ministria e Mbrojtjes, kazemat me ushqim u furnizuan nga Agjencia Qendrore e Prokurimit përmes kompanisë "Hajdini Comerc", që aktualisht furnizon me ushqim disa institucione të tjera. Por, kjo kompani është fituese edhe në tenderin e Ministrisë së Mbrojtjes, megjithëkëtë i njëjti nuk është nënshkruar dhe, siç ka konfirmuar ministri Maqedonci, është në auditim të brendshëm.

Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave e të Lirive të Njeriut (KMDLNj) ka reaguar në lidhje me furnizimin me gjëra ushqimore për Forcën e Sigurisë së Kosovës (FSK). "Për shkak të gjërave, ende të pasqaruara deri në fund, FSK-ja rrezikohet që pas datës 1 tetor 2024 të mbetet pa furnizime me gjëra

ushqimore për pjesëtarët e saj dhe stafin civil. Pasi ishte koha shumë e shkurtër për një operator tjetër e që atij paraprak i kishte kaluar afati, me qëllim të tejkalimit të situatës u kërkua ndihmë nga Shërbimi Korrektues i Kosovës që të sigurojë personel të kualifikuar për përgatitjen e ushqimit për FSK-në, deri në një zgjidhje të qëndrueshme. Dhe, si zgjidhje e imponuar nga papërgjegjësia e institucioneve të ngarkuara me këtë çështje u gjet 'zgjidhja e Solomonit'; ushqimi do të përgatitej nga kuzhinat e burgjeve të Kosovës dhe Mensa e Studentëve", thuhet në reagimin e KMDLNj-së, duke shtuar se nuk mbahet mend një rast i tillë në Kosovën e pasluftës, por as edhe në një kohë tjetër aq më parë që të burgosurit kanë kryer punë më pak të kualifikuara dhe me përgjegjësi më të vogël. "KMDLNj gjithmonë ka deklaruar se në burgjet e Kosovës ushqimi është i një cilësie të mirë qoftë sa i përket kalorive apo edhe sasisë. Udhëheqësit e kuzhinave ku përgatitet ushqimi apo edhe ruhet janë civilë kurse ata që ndihmojnë janë kryesisht të burgosur që kanë përvojë para se të dënohen. KMDLNj gjithmonë ka vlerësuar pozitivisht punën e Shërbimit Korrektues të Kosovës ndërkohë që opinioni, në mungesë të informatave ka pasur mendime



të ndara. Po të mos ishte ndërhyrja brutale politike, SHKK do të bënte edhe punë tjera të mira. Për KMDLNj mbetet shqetësues fakti se puna e të burgosurve nuk vlerësohet ndonëse kryejnë punë të kualifikuara ku kërkohet edhe siguria siç është kjo me FSK-në që ndërlikohet shumë edhe me sigurinë. Për punën që e bëjnë kompensimi është minimal, madje edhe nënçmues në ndërkohë që nuk përfitojnë shumë nga beneficionet që iu takojnë, fundjava në shtëpi, lirimi me kusht,

falja apo edhe shfrytëzimi i pushimit vjetor", thuhet në këtë reagim.

Sipas KMDLNj-së, të burgosurit që punojnë duhet të trajtohen sipas Ligjit të Punës duke i realizuar të drejtat që u takojnë.

KMDLNj ka përgëzuar Shërbimin Korrektues të Kosovës që, përkundër shumë problemeve që i ka, ka dëshmuar vullnet dhe gatishmëri ta ndihmojë FSK-në deri në tejkalim të gjendjes. "KMDLNj fton Prokurorinë e Shtetit të bëjë hetime urgjente për

situatën e krijuar në FSK shkak të po flitet për kontrata të nënshkruara kundërligjshëm dhe pa pëlqimin e ministrit të Mbrojtjes e që pastaj është anuluar. Është e pabesueshme që pas këtij skandali të paparë kur një ushtri mbetet pa ushqime, me fajin e drejtuesve të këtij institucioni, askush të mos i nënshtrohet përgjegjësisë, qoftë edhe asaj morale ose të shkarkohet nga KM i Kosovës", është theksuar në reagimin e KMDLNj-së.

## Procesi i Berlinit bashkon ministrat e Punëve të Jashtme, bëhet thirrje për bashkëpunim rajonal dhe zbatim të zotimeve

EPOKA  
ERE

Qendresa RAMA

BERLIN, 2 TETOR - Sekretarja e përgjithshme e Këshillit të Bashkëpunimit Rajonal (RCC), Majlinda Bregu, mori pjesë në takimin e Ministrave të Punëve të Jashtme të Procesit të Berlinit që u zhvillua në kryeqytetin gjerman.

Ministrja e Jashtme gjermane, Annalena Baerbock, ka vlerësuar punën e RCC-së dhe sekretares së përgjithshme të saj Majlinda Bregu, duke theksuar kontributin e tyre vendimtar për zbatimin e Planit të Veprimit të Përbashkët Rajonal të Tregut. "Duke tërhequr vijnë pas 10 viteve të Procesit të Berlinit, mund të them se ka shumë për t'u krenuar në drejtim të avancimeve konkrete dhe ndikimit të manifestuar përmes agjendave tona të bashkëpunimit rajonal. Rrjedha e pandërprerë e furnizimeve kritike gjatë pandemisë dhe më gjerë, korsi të gjelbra janë tashmë një realitet jo vetëm brenda Ballkanit, por të shtrira tashmë me BE-në; Rritje 19 % e tregtisë së mallrave dhe shërbimeve; dyfishimi i vëllimit të tregtisë (mallrave) ndër-rajonal në 5 vjet; 500 % rritje e volumit të përdorimit të roaming brenda BB; gati 1 200 kompani të reja morën



pjesë në tregtinë ndër-rajonale; lehtësoi lëvizshmërinë e fuqisë punëtore dhe adresoi dinamikat në zhvillim të tregut të punës dhe ndryshimet demografike me kualifikimet e arsimit të lartë dhe shtatë profesione të njohura reciprokisht. E gjithë kjo e njohur dhe e panjohur, rezultoi që 82 % e qytetarëve të Ballkanit Perëndimor të mbështesin bashkëpunimin rajonal", tha Bregu në takim, duke shtuar se RCC-ja, në krye të të cilit pati nderin të shërbejë në gjashtë vitet e fundit, udhëhoqi punën për një treg të përbashkët rajonal si kuadrin kyç unifikues dhe deri tani më të përpunuar bashkëpunimin

dhe integrimin rajonal. Ajo tregoi se çfarë mund të ketë një treg i vërtetë rajonal. "Duke ofruar gjithashtu një paraqitje të shkurtër të potencialeve të Tregut të Vetëm, megjithatë, pengesat e mbetura, bllokimet politike ose angazhimet e paplotësuar, së bashku me potencialet ende të mëdha të pashfrytëzuara, janë gjithashtu pjesë e të njëjtit libër ekuilibri që rajoni duhet të kërkojë të trajtojë", ka thënë Bregu, duke theksuar se RCC-ja, së bashku me partnerët, po punon për Planin e Veprimit CRM 2, miratimi i të cilit pritet në Samitin e Procesit të Berlinit në fund të këtij muaji. "Bashkëpunimi

rajonat nuk duhet të jetë vetëm për nënshkrimin e marrëveshjeve, por për zbatimin e plotë të zotimeve. Nuk mjafton të tregosh gishtat ose të presësh që të tjerët të udhëheqin. Ka vend që të gjithë të bëjnë më shumë. Ne të gjithë kemi nevojë për më shumë integrim sesa shpërbërje; ne të gjithë kemi nevojë për më shumë bashkëpunim sesa izolim; ne të gjithë kemi nevojë për më shumë bashkim jo me fjalë por me vepra; ne kemi nevojë për planifikim më të mirë dhe instrumente financiare të qëndrueshme si pjesë e anëtarësisë të ri gradual të BB-së në BE, ne kemi nevojë për një mentalitet të rritjes, jo vetëm për një plan zhvillimi. Ky është një udhëtim kolektiv nëse duam të drejtojmë ndryshime reale të qëndrueshme. Bashkëpunimi nuk është një zgjidhje, por një domosdoshmëri! Ne ia kemi borxh vetes dhe brezave të ardhshëm", përfundoi Bregu.

Në takimin e ministrave të Punëve të Jashtme në kuadër të Procesit të Berlinit, me ftesë të ministres së Punëve të Jashtme të Gjermanisë, Annalena Baerbock, zëvendëskryeministrja dhe ministrja e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës, Donika Gërvalla, theksoi se bashkëpunimi rajonal

është kyç për përparimin e rajonit, jo vetëm në aspektin e partneritetit, por për gjithë procesin e Ballkanit Perëndimor. Ajo tha se Republika e Kosovës mbetet e përkushtuar për t'i forcuar marrëdhëniet kyçe dhe për ta siguruar paqen dhe stabilitetin e plotë në Ballkanin Perëndimor. Ministrja Gërvalla ka theksuar se përparimi drejt integritetit evropian kërkon përmbushjen e angazhimeve të marra në kuadër të Procesit të Berlinit, me fokus në katër marrëveshjet të cilat mundësojnë katër liritë themelore të BE-së, lirinë e lëvizjes së njerëzve, mallrave, shërbimeve dhe kapitalit. Sipas saj, implementimi i këtyre marrëveshjeve nga të gjitha shtetet do të sjellë përfitime të prekshme për qytetarët dhe do të ndihmojë në stabilizimin e rajonit.

Pas takimit, ministrat e Jashtëm të BE-së dhe Ballkanit Perëndimor lëshuan një deklaratë për zgjerimin e bashkëpunimit, duke vënë në dukje arritjet në agjendat e CRM të koordinuara nga RCC. Ata ranë dakord për Deklaratën e Përbashkët që rikonfirmon marrëdhëniet e mira fqinjësore dhe bashkëpunimin rajonal që pritet të miratohet në Samitin e Berlinit në fund të këtij muaji.

# Sarrazin në Prishtinë: Tregu rajonal do të mundësonte zhvillim

EPOKA ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 2 TETOR - I dërguari i posaçëm i Gjermanisë për Ballkanin Perëndimor, Manuel Sarrazin, tha se Gjermania është ndër partnerët kryesorë të Kosovës, si ekonomikisht ashtu edhe politikisht, sepse beson në të ardhmen dhe potencialin që ka ajo. Ai tha se Kosova duhet të krijojë parakushte për më shumë investime dhe bëri thirrje që të punohet për një treg të përbashkët rajonal, i cili do të mundësonte zhvillim.

Sarrazin i bëri komentet në Forumin e Dytë Ekonomik Gjermano-Kosovar, të organizuar nga Oda Ekonomike Gjermano-Kosovare në Prishtinë, në bashkëpunim me Komitetin Lindor të Ekonomisë Gjermane. "Të gjitha ekonomitë në Ballkan nuk janë një treg i mjaftueshëm që të vijë një kompani. Shumë investitorë shkojnë në Serbi. Duan të investojnë atje dhe të bëjnë biznes me të gjithë rajonin. E ne

duam që kjo të ndryshojë. Duam që investitorët të vijnë në Kosovë dhe të krijojnë një treg i përbashkët rajonal", tha Sarrazin. "Unë nuk di ndonjë investitor nga Gjermania që është duke investuar në ndonjë nga vendet e Ballkanit Perëndimor dhe që nuk shikon potencialin e vendeve fqinje në të gjithë rajonin", shtoi ai.

Javëve të fundit Sarrazin ishte i zëshëm në thirrjet drejtuar Kosovës për ta hequr ndalesën ndaj importit të mallrave të prodhuara në Serbi.

Kjo ndalesë është në fuqi për më shumë se një vit - për "arsye sigurie", sipas Qeverisë së Kosovës. Por, sipas Sarrazinit, ajo është në kundërshtim me Marrëveshjen për Tregti të Lirë të Evropës Qendrore (CEFTA), pjesë e së cilës është edhe Kosova. Për pasojë, ai ka përmendur më herët edhe mundësinë e përjashtimit të Kosovës nga CEFTA.

Në hapje të forumit në Prishtinë foli edhe zëvendëskryeministri i Kosovës, Besnik Bislimi, i cili tha



se gjatë katër vjetëve të fundit qeverisjeje, në Kosovë ka pasur rritje ekonomike dhe të punësimit.

Në fillim të këtij viti edhe Banka Botërore parashikoi rritje ekonomike në Kosovë për 3.9 për qind krahasuar me 3.2 për qind vitin e kaluar.

I pranishëm në këtë ngjarje ishte edhe kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj, i cili tha se Gjermania ka qenë dhe mbetet një shtyllë e fortë në krijimin dhe ndërtimin e shtetit të Kosovës, si dhe një ndër partnerët tanë kryesorë. "Për fat të keq, me qasjen vetizoluese të

Qeverisë së Kosovës vendi ynë është përjashtuar nga harta e investimeve të jashtme. Këtë e theksoi edhe i dërguari special i Gjermanisë për Ballkanin Perëndimor, Manuel Sarrazin, në Forumin e Dytë Ekonomik Gjermano-Kosovar, të organizuar nga Oda Ekonomike Gjermano-Kosovare, ku konfirmoi shqetësimin tonë se shumë investitorë po u drejtohen shteteve të tjera të rajonit", ka pohuar Haradinaj.

Ai ka theksuar se vetizolimi i Kosovës po na sjell jo vetëm dëme politike, por edhe dëme të mëdha ekonomike. "Kjo po reflektohet qartë në largimin masiv të fuqisë punëtore dhe mungesën e vendeve të reja të punës për shkak të mungesës së investimeve. Kosovës i duhet ndryshim urgjent për ta kthyer vendin në rrugën e zhvillimit. Ne kemi potencial në inovacion dhe zhvillim, por për të përfutur nga ky potencial, na duhet një mentalitet i ri qeverisës", ka deklaruar Haradinaj.

## Bordi i Drejtorëve i AKP-së miratoi 5 dhe refuzoi 17 shitje të aseteve

PRISHTINË, 2 TETOR - Bordi i Drejtorëve i Agjencisë Kosovare të Privatizimit ka mbajtur mbledhjen e radhës, në të cilën ka diskutuar për një numër çështjesh të parapara në agjendë dhe ka marrë disa vendime në lidhje me administrimin, privatizimin dhe likuidimin e ndërmarrjeve shoqërore.

Bordi nga fushëveprimi i vet aprovoi kërkesën për transferimin e pronës së NSh Drenica (PRN011), Gllgoc, me detajet e pronës: Prona e paluajtshme nr. 244-0 ZK Sankoc për realizimin e projektit "Ndërtimi i fabrikës së riciklimit dhe përpunimit të nënprodukteve shtazore për nevoja të Agjencisë së Ushqimit



dhe Veterinarisë së Kosovës (AUV)", që titulli pronësor të kalojë në emër të Qeverisë së

Republikës së Kosovës/Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë (AUV), në

përputhje me Vendimin Përfundimtar të Qeverisë së Republikës së Kosovës për Shpronësim nr. 04/58, të datës 12 nëntor 2015.

Bordi diskutoi edhe për disa asete që shfrytëzohen për interes publik, për të cilat u vendos që të hiqet dorë (18 parcela) dhe të barten në komunat përkatëse pasi të aprovohen nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme, si dhe vendosi për një numër të qiradhënieve direkte të aseteve të ndërmarrjeve shoqërore.

Në vijim të mbledhjes, Bordi shqyrtoi rezultatet e ofertave të pranuar për pronat që ishin në tender në shitjen e aseteve përmes likuidimit nr. 68, ku miratoi 5 dhe refuzoi 17 shitje të

aseteve. Po ashtu, u shqyrta dhe u aprovua lista e aseteve për shitjen nr. 69 (ShAL 69), e cila do të shpallet në ditët në vijim.

Në këtë mbledhje u shqyrta dhe u aprovuan raportet e shpërndarjes në likuidim për N. Sh. "Industria e Duhanit Gjilan - Tobacco" dhe N. Sh. "Ratar". Bordi shqyrtoi edhe raportin mujor të menaxhmentit, me theks të veçantë atë për N. Sh. Ineks Brezovica, si dhe çështjet e zbatimit të vendimeve të Bordit nga menaxhmenti lidhur me përgatitjet sa më të mira për sezon.

Më tutje, Bordi diskutoi dhe miratoi amendamentimin e Rregullores për Shitje Direkte dhe Rregullores për Ofruesit e Shërbimeve.

## SBASHK-u: Urgjentisht të zgjidhet çështja e pagave për punëtorët e arsimit në Viti

PRISHTINË, 2 TETOR - Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës (SBASHK) ka bërë thirrje që urgjentisht të zgjidhet çështja e pagave për punëtorët e arsimit në Viti.

Kryetari i SBASHK-ut, Rahman Jasharaj, ka thënë se me anëtarë të stafit qendror do të shkojnë në Viti dhe do të takohen me anëtarët e Kuvendit të Sindikatës së Arsimit Parauniversitar për këtë komunë, për të folur rreth situatës së krijuar e për të marrë vendime për veprime konkrete. "SBASHK-u iu gëzua

lajmit se u krijua mundësia për procedimin e pagave të punëtorëve të arsimit, por informacionet flasin se kjo gjë nuk ndodhi edhe për punëtorët e arsimit në komunën e Vitisë, të cilët padrejtësisht ende kanë mbetur pa pagën e muajit shtator. SBASHK-u pa dashur të ndalet e të emëroj fajtorin i drejtohet Ministrisë së Financave dhe institucioneve qendrore e lokale që ta bashkëbisedojnë dhe të gjejnë zgjidhje të duhur në mënyrë që punëtorët e arsimit në Viti

të marrin që sot pagat e shtatorit. Nëse kjo nuk ndodh atëherë SBASHK-u në nivelin qendror vazhdon të mbajë komunikim me kryetarin e nivelit komunal sindikal për Vitinë, Kemajl Bislimi dhe me udhëheqës sindikal në këtë komunë dhe do të mbështes çdo angazhim të tyre dhe do t'u qëndroj pranë e do të solidarizohet me ta edhe nëse ata fillojmë me veprime sindikale duke mos përjashtuar edhe grevën", është thënë në njoftimin e SBASHK-ut.





# Pse farisenjtë ishin ‘të këqinjte’ në Bibël?

Jezu Krishti e humbet gjakftohtësinë vetëm në pak raste në Dhiatën e Re (thjesht pyesni këmbesit e parave në Tempull), por ai lëshon një nga tiradat më të forta te Mateu 23, kundër farisenjve dhe të tjerëve “mësues të ligjit”.

## Në cilat vargje i kritikon Jezusi farisenjtë?

Në vargjet 13-39, të njohura si “shtatë plagët”, Jezusi i quan farisenjtë “hipokritë” gjashtë herë. Ai i quan gjithashtu “të verbër” (pesë herë), “fëmijët e ferrit”, “pjellë nepërkash” dhe e krahason devotshmërinë dhe qëndrimin e rremë të farisenjve me “varret e zbardhura, të cilat duken bukur nga jashtë, por nga brenda janë plot me eshtra të vdekurish dhe çdo gjë të papastër”.

Farisenjtë e Testamentit të Ri konsiderohen qartazi si të këqinjte, kontrastet e përsosura ideologjike dhe shpirtërore për Jezusin dhe pasuesit e tij. Farisenjtë përshkruhen si zbatues të shkathët të shkrimeve të shenjta judaike, të cilët janë të përqendruar me aq ngulm në shkronjën e ligjit, sa që u mungon krejtësisht shpirti.

Siç thotë Jezusi: “Ju jepni një të dhjetën e erëzave tuaja – nenexhik, kopër. Por ju keni lënë pas dore çështjet më të rëndësishme të ligjit – drejtësinë, mëshirën dhe besnikërinë. Duhet të kishit praktikuar të dytën, pa lënë pas dore të parën. Ju udhërrëfyet të verbër! Ju nxirrni jashtë një mushkonjë, por gëlltitni një deve.”

Por a përputhet kjo pamje e farisenjve – si legalistë hipokritë – me atë që historianët dhe studiuesit fetarë dinë për lëvizjen reale fariseike, e cila fitoi rëndësi gjatë periudhës së tempullit të dytë të judaizmit?

Bruce Chilton, profesor feje në Kolegjin Bard dhe bashkë-redaktor i librit “Në kërkim të farisenjve historikë”, tregon se çfarë besonin farisenjtë në të vërtetë dhe pse u përplasën me të krishterët e hershëm.

## Kush ishin farisenjtë – dhe saducenjtë?

Gjatë shekullit të parë të e.s., kur jetoi Jezui, farisenjtë u shfaqën si një lëvizje fetare brenda judaizmit, jo një sekt i veçantë. Tempulli qëndronte ende në Jerusalem dhe ishte qendra e jetës hebreje. Një nga shqetësimet më të mëdha të rriteve të tempullit ishte pastërtia: që si njerëzit që hynin në tempull ashtu edhe kafshët e fljuara atje, të ishin mjaftueshëm “të pastra” për të kënaqur Zotin.

Tora (pesë librat e parë të Biblës Hebraike, duke filluar me Zanafillën) përmban urdhërime të shkruara që shpjegojnë mënyrën e duhur për të kryer flijimet në Tempull, por farisenjtë besonin se ata kishin udhëzime hyjnore shtesë që ishin përcjellë nëpër shekuj përmes traditës gojore. “Farisenjtë besonin se ata kishin një rezervë të veçantë njohurish për përcaktimin e pastërtisë,” thotë Chilton. “Ata mësuan se tradita e tyre gojore shkonte pas në kohë deri tek Moisiu në Sinai, kështu që jo vetëm që kishte një Tora të shkruar, në të cilën çdokush mund të kishte qasje, por kishte edhe një Tora gojore që ishte brenda lëvizjes fariseike.”

Ajo që dallonte në ligjin e farisenjve ishte se ai e zgjeroi çështjen e pastërtisë në jetën jashtë Tempullit. Edhe nëse një person hebre jetonte larg Jerusalemit (në Galile, për shembull) dhe nuk planifikonte të bënte një pelegrinazh në Tempull, ai mund ta bënte jetën e tij në atë mënyrë që të ishte mjaft i pastër për të hyrë në Tempull. “Në këtë kuptim, farisenjtë u bënë një lëvizje për pastërtinë e popullit hebre”, thotë Chilton.

Megjithatë, farisenjtë nuk ishin elita e fuqishme e judaizmit të shekullit të parë. Ata ishin një sekt tjetër hebre: saducenjtë, klasa priftërore që kontrollonte adhurimin e tempullit dhe kishte ndikimin më të madh politik tek Perandoria Romake, e cila sundonte mbi Palestinën. Saducenjtë e hodhën poshtë ligjin gojor në favor të ligjit të shkruar të vendosur në Tora. Farisenjtë ishin një lëvizje e klasës punëtore që merrej me vendosjen e një identiteti të qartë dhe të qëndrueshëm hebre në jetën e përditshme.

Është interesante se ishin farisenjtë ata që besuan në një jetë të përtejme dhe në ringjalljen e të vdekurve, të cilat të dyja u refuzuan nga saducenjtë pasi nuk përmendeshin në Tora. Një mënyrë tjetër se si farisenjtë ndryshonin nga tradita judaike është se ata besonin që një mesia do të vinte dhe do të sillte paqe në botë, megjithëse shumica e tyre nuk mendonin se mesia ishte Jezusi.

## Jezu Krishti kishte miq (dhe ndjekës) që ishin farisenj

Farisenjtë janë portretizuar si një bllok monolit në Dhiatën e Re, por Chilton thotë se ndërsa të gjithë farisenjtë merakoseshin për pastërtinë, midis farisenjve pati një debat të ashpër për mënyrën më të mirë për ta



arritur atë. Sigurisht që kishte farisenj që besonin se pastërtia fitohej nga jashtë brenda dhe që mësonin se banjot rituale (mikvahs) dhe pastrimi ritual i kupave dhe mjeteve të gatimit ishte e vetmja mënyrë për të arritur pastërtinë.

Tek Mateu 23, Jezusi kritikon traditën fariseike të pastrimit të pjesës së jashtme të kupave dhe pjatave, ndërsa “brenda janë plot babëzi dhe vetëkënaqësi”. “Për shkak se vetë Jezusi ishte i angazhuar në çështjen e pastërtisë – por nuk ishte farise – konflikti i tij me disa farisenj të kohës së tij ishte i pashmangshëm,” thotë Chilton. “Nëse e akuzon dikë si të papastër, nuk po thua se pastërtia nuk ka rëndësi; po thua të kundërtën – ka një mënyrë më të mirë për ta arritur atë.”

Por Chilton thotë se kishte farisenj të tjerë që u pajtuan me Jezusin, se puna e vërtetë e pastrimit fillon me një zemër të pastër dhe besim në Zot. Nëse e lexoni nga afër Testamentin e Ri, në fakt, do të shihni se Jezusi fitoi përkrahës dashamirës dhe madje ndjekës nga radhët e farisenjve të supozuar si të urryer. Nikodemi, i cili e vizitoi Jezusin natën për t’i bërë pyetje dhe më pas i siguroi para dhe erëza për t’i bërë një varrim të duhur hebre pas kryqëzimit, ishte një farise (shih Gjoni 3). Dhe te Luka 13:31, një farise vjen për të paralajmëruar Jezusin se Herodi donte që ai të vritej. Por ndoshta përmendja më interesante dhe më e rëndësishme e farisenjve “miqësorë” vjen në librin e Veprave të Apostujve, kur një grup farisenjsh renditet në mesin e ndjekësve të hershëm të Jezusit që qëndruan besnikë pas vdekjes së tij.

## Takimi që i dënoi farisenjtë

Në Veprat e Apostujve 15, ka një mbledhje ose “këshill” në Jerusalem ku marrin pjesë Pali,

Pjetri, Jakobi, Barnaba dhe apostuj dhe ndjekës të tjerë të Jezusit. Axhenda e takimit ishte të zgjidhte një çështje të rëndësishme midis kishës së hershme: A duhej të rrethpreshin burrat johebrenj që të pagëzoheshin dhe të merrnin Frymën e Shenjtë?

Farisenjtë e pranishëm ishin të parët që këmbëngulën. Në Veprat e Apostujve 15:5, thuhet: “Atëherë disa nga besimtarët që i përkisnin partisë së farisenjve u ngritën dhe thanë: “Johebrenjtë duhet të rrethpreshin dhe t’u kërkohet të respektojnë ligjin e Moisiut”. Vini re se thotë se farisenjtë ishin ndër “besimtarët”, një provë tjetër që disa farisenj, gjithashtu, ishin ndjekës të hershëm të Jezusit.

## Mosmarrëveshjet në ligjin hebre

Por ja ku gjërat marrin për keq. Apostujt janë në mosmarrëveshje të thellë me farisenjtë dhe thonë se të gjithë, të rrethprerë apo të parrethprerë, mund t’i pastrojnë zemrat e tyre nëpërmjet besimit në Krisht. Pjetri, duke pranuar dhimbjen fizike dhe rrezikun e rrethprerjes së një të rrituri, i qorton farisenjtë në vargjet 10 dhe 11: “Tani, pra, përse përpiqeni ta vini në provë Perëndinë duke u vënë në qafë johebrenjve një zgjedhje që as ne dhe as paraardhësit tanë nuk kemi mundur ta mbajmë? Jo! Ne besojmë se jemi të shpëtuar nëpërmjet hirit të Zotit tonë Jezus”.

Pali sulmon këdo që mbështet përdorimin e gjerë të rrethprerjes si hipokrit, legalist dhe i shkëputur nga Krishti. Dhe ky është pak a shumë mendimi i Dhiatës së Re për farisenjtë. Duket se ishte kjo mosmarrëveshje e brendshme mes pasuesve të Jezusit që krijoi këtë vijë të ashpër të demarkacionit midis të krishterëve dhe farisenjve. Sektet e lashta hebreje kundër

besimtarëve të hershëm të krishterë

Ajo që është e rëndësishme të kuptohet është se katër ungjijtë e Dhiatës së Re (Mateu, Marku, Luka dhe Gjoni) u shkruan duke filluar nga viti 70 i e.s., disa dekada pas mbledhjes në Jerusalem. Pra, është shumë e mundur që vetë Jezusi nuk ka pasur një neveri të tillë për farisenjtë gjatë jetës së tij, por që autorët e Dhiatës së Re i shkruan ungjijtë pas divorcit të tyre të shëmtuar me farisenjtë për rrethprerjen. “Ungjijtë janë shkruar nga këndvështrimi i një shkeljeje që nuk kishte ndodhur në kohën e Jezusit,” thotë Chilton.

## Çfarë ndodhi me farisenjtë?

Pasi Tempulli i Dytë u shkatërrua në vitin 70 të e.s., Chilton thotë se struktura e pushtetit të jetës fetare hebreje u rrëzua bashkë me të. Saducenjtë, të cilët kishin qenë forca më me ndikim gjatë periudhës së Tempullit të Dytë, u shpërndanë, ndërsa farisenjtë e dobësuar u shfaqën si autoriteti i fundit që qëndronte në historinë hebraike.

Gjatë shekujve që pasuan, traditat gojore të farisenjve u angazhuan për të shkruar në Mishnah dhe më pas u komentuan në Talmudin Babilonas, duke u bërë baza për Judaizmin Rabinik. “Të urtët” fariseikë që kishin transmetuar traditën gojore që nga koha e Moisiut u zëvendësuan nga rabinët e ditur që studionin Tevratin dhe komentet komplekse që gjenden në Talmud.

Judaizmi modern është, në një farë kuptimi, një vazhdim i fjalës hebraike të mbrojtur për herë të parë nga farisenjtë. /bota.al



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

## Kuka: Duhet të jepet përgjegjësi për mosrezultate

**PRË, 2 TETOR** - Driton Kuka ka ardhur me një propozim për shtetin dhe për Ministrinë e Sportit. Trajneri më i suksesshëm nga Kosova ka thënë se MKRS-ja duhet të krijojë mekanizma për përgjegjësi dhe të marrë model ndonjë shtet të fuqishëm evropian. Sipas Kukës, shteti duhet të krijojë mekanizma për përgjegjësi për federatat e klubet që po marrin financa shumë të mira dhe nuk po kanë përgjegjësi për rezultate. "Cikli olimpiq përfundoi, rrjedhimisht koha e përgjegjësi në çdo federatë! Koha kur tashmë po mbahen zgjedhje e do të mbahen të tjera nëpër federata e Komitet Olimpik! S'dua të flas se çka ka ndodhur në shumë federata e as se sa e kush ka punuar e merituar të jetë në KOK. Por dua të besoj që është koha e fundit që shteti të krijojë mekanizma për përgjegjësi për federatat e klubet që po marrin financa goxha të mira e përgjegjësi për rezultate pak ose fare po kërkohet", ka thënë Kuka.

"Lojërat Olimpikë morën fund e shumica federatave apo krerëve të federatave s'po e marrin mundin të flasin për arsytet pse as Norma Olimpikë



s'mund të arrihen e lëre më medalje. Ministria e Sportit të krijojë mekanizma për përgjegjësi. Merrni model ndonjë shtet, ju lutem! Në Gjermani, për shembull, kandidati për kryetar të

ndonjë federate kandidon me program e cak që e prezanton te shteti e nëse nuk e arrin cakun, ai s'do të kandidoj më, se shteti nuk financon ata që nuk kanë sukses dhe pikë!", ka shtuar Kuka.

## Dekani Miftari paraqet ekipin e ri në Fakultetin e Edukimit Fizik dhe Sportit

**PRISHTINË, 2 TETOR** - Dekani i ri i Fakultetit të Edukimit Fizik dhe Sportit, prof. asst. Florian Miftari, ka emëruar ekipin e prodekanëve, duke përzgjedhur personalitete të spikatura akademike që do të ndihmojnë në drejtimin dhe avancimin e fakultetit në nivele të reja. Në pozicionin e prodekanit për Mësim dhe Çështje të Studentëve është emëruar prof. asst. Malsor Gjonbalaj, një figurë me përvojë të gjatë në sport dhe edukimin në mbështetjen e studentëve. Përveç ekspertizës së tij të njohur në fushën e futbollit dhe edukimit fizik, prof. Gjonbalaj do të luajë një rol të rëndësishëm në përmirësimin e përvojës akademike të studentëve dhe zhvillimin e programeve mësimore. Në pozicionin e Prodekanit për Shkencë dhe Marrëdhënie me Jashtë është emëruar prof. asst. Faton Tishukaj. Me një karrierë të shkëlqyer ndërkombëtare në kërkimin shkencor dhe një përkushtim të madh për ndërtimin e urave bashkëpunuese ndërkombëtare, prof. Tishukaj do të jetë një figurë kyçe në avancimin e projekteve kërkimore të fakultetit dhe krijimin e partneriteteve të reja me institucione të huaja. Fakulteti i Edukimit Fizik dhe Sportit me këtë ekip të ri drejtues është i përkushtuar t'i vazhdojë përpjekjet për arritje të larta akademike dhe të ndërkombëtarizohet gjithnjë e më shumë, duke u ofruar



studentëve mundësi të reja për zhvillim personal dhe profesional. "U urojmë prodekanëve të sapozgjedhur shumë suksese në misionin e tyre dhe besojmë

se nën drejtimin e këtij ekipi të përkushtuar, Fakulteti do të arrijë në nivele të reja të shkëlqimit!", thuhet në njoftimin e FEFS-së.

### SHKURT

#### FFK-ja dënohet 61 mijë euro për ndeshjen ndaj Rumanisë

Incidentet e shumta gjatë ndeshjes së muajit të kaluar midis Kosovës dhe Rumanisë i kanë kushtuar Federatës së Futbollit të Kosovës me gjobë prej 61 mijë eurosh. Shkeljet përfshinin hyrjen e shikuesve në fushë, hedhjen e gjësendeve, ndezjen e fishekzjarrëve, fishkëllimat gjatë himnit të Rumanisë dhe bllokimin e rrugëve publike përreth stadiumit. Ndeshja e zhvilluar më 6 shtator në stadiumin "Fadil Vokrri" në Prishtinë në kuadër të Ligës së Kombeve kishte përfunduar me fitoren e Rumanisë me rezultat 3-0. Ka disa herë që Kosova dhe Rumania ndeshen në garat ndërkombëtare dhe disa herë ndeshjet janë shoqëruar me incidente. Herën e fundit Federata e Futbollit e Rumanisë, lidhur me ndeshjen kualifikuese për Euro 2024 kundër Kosovës, pas një hetimi për disa shkelje, ishte gjobitur me 52 mijë euro, si dhe ishte dënuar me një ndeshje pa tifozë nga UEFA.

#### Peja mposhti Borën për fitoren e parë në Superligë

Në një ndeshje mjaft interesante Peja ka shënuar fitore ndaj Borës me shifrat 93:98 (24:30, 14:24, 25:20, 30:24) në javën e tretë të ProCredit Superligës. Mysafirët ishin më të mirë në pjesën e parë, duke e fituar çerekun e parë 24:30, derisa të dytën 14:24, për të shkuar në pushim me shifrat 38:54. Por, asgjë nuk kishte përfunduar, pasi skuadra prishtinase fillon të rikthehet, duke afruar shifrat në minimalisht një pikë, 92:93, por nuk arriti të bëjë më shumë dhe Peja triumfoi 93:98. Te Bora u dalluan Alex Avein Lomax me 19 pikë e gjashtë kërcime dhe Ardarryl Clay Jr me 20 pikë e pesë asistime, kurse te Peja më i miri ishte Darnell Cowart me 25 pikë dhe tetë kërcime. Peja ka një fitore e një humbje, kurse Bora tri humbje.

#### Maqedonia e Veriut me pesë shqiptarë kundër Letonisë dhe Armenisë

Përzgjedhësi i Maqedonisë së Veriut në futboll, Bllagoja Milevski, ka shpallur listën e lojtarëve të thirrur për dy ndeshjet e ardhshme në Ligën e Kombeve. Edhe kësaj radhe në listën e Milevskit nuk kanë munguar emrat e futbollistëve shqiptar, të cilët janë standard në duelet e fundit. Visar Musli – Paderborn (Gjermani), Ezgjan Alioski – Al Ahli (Arabia Saudite), Enis Bardhi – Trabzonspor (Turqi), Isnik Alimi – Sepsi (Rumani) dhe Lirim Qamili – Sonderjiske (Danimarkë). Maqedonia e Veriut dy ndeshjet e radhës do t'i luajë në cilësinë e mysafires me Letoninë dhe Armeninë dhe pikërisht për këtë Milevski vendosi të thërrasë edhe dy emra të rinj nga përfaqësuesja e U-21. Është Mario Ilievski, i cili tashmë ishte thirrur pas lëndimit të Millan Ristovskit, ndërsa ftesë ka marrë edhe mbrojtësi i Zhilinit nga Sllovakia, Andrej Stojčevski. Më 10 tetor Maqedonia e Veriut luan në Riga me Letoninë, ndërsa tri ditë më vonë luan kundër armenëve në Jerevan.

## U hap programi i edukimit 'Trajner Sportiv'

PRISHTINË, 2 TETOR - Komiteti Olimpik i Kosovës përmes Akademisë Olimpikë ka nisur për herë të parë programin e edukimit "Trajner Sportiv", program ky i akredituar në fillim të këtij viti nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve. Krahas udhëheqësve të KOK-

ut, në ceremoninë hapëse morën pjesë drejtues të federatave sportive, të MKRS-së, të komunës së Prishtinës, profesorë të FEFS-sit dhe Kolegjit AAB etj. Presidenti i KOK-ut, Ismet Krasniqi, theksoi se synimet e këtij programi janë të krijojë

trajnerë të aftë e të përgatitur profesionalisht, të cilët do të kenë ndikim të madh në zhvillimin e sportistëve dhe rritjen e sukseseve ndërkombëtare të Kosovës. Programin e vlerësuan lart edhe drejtori i Departamentit të Sportit në MKRS, Ibër Alaj,

ish-dekani i FEFS-sit, Musa Selimi dhe dekani i Kolegjit AAB, Fatmir Pireva. Programin "Trajner Sportiv" e prezantuan në detaje udhëheqësit e Akademisë Olimpikë, koordinatori i edukimit arsimor, Fitim Arifi dhe koordinatorja e vlerave



olimpikë, Diellza Kelmendi. Gjeneratën e parë të programit do ta vijojnë 46 vijues, të cilët kryesisht vijnë nga federatat

## 11 vjet pas aksidentit të rëndë, Schumacheri shfaqet për herë të parë në publik

GJENEVË, 2 TETOR - 11 vjet pas aksidentit të rëndë që pësoi, Michael Schumacheri është shfaqur për herë të parë në publik. Sipas medieve të huaja, shtatë herë kampioni i botës në Formula 1 mori pjesë në dasmën e vajzës së tij Gina-Maria. Schumacheri pësoi lëndime që ia ndryshuan jetën gjatë një aksidenti në ski në vitin 2013 dhe që prej asaj kohe familja ka refuzuar të japë detaje për gjendjen e tij. Por tani thuhet se ai ishte i pranishëm për ta parë vajzën e tij të lidhte martesën me bashkëshortin e saj Ian Bethke, sipas "The Mirror". Schumacher tregon kujdes gjatë gjithë kohës pas aksidentit të tij në Alpet Franceze më shumë se një dekadë më parë, pasi kishte goditur kokën në një shkëmb, pavarësisht se kishte veshur një helm të ndërsa bënte ski me



djalin e tij Mick. Ai u transportua me helikopter në Spitalin e Grenobles ku iu nënshtrua dy ndërhyrje kirurgjikale përpara se të vendosej në koma të shkaktuar nga mjekësia për disa

muaj. 55-vjeçari më vonë u kthye në shtëpinë e tij në Liqenin e Gjenevës në shtator 2014, ku për të është kujdesur gruaja e tij Corinna dhe ekipi i profesionistëve mjekësorë.

## Fury mori një mësim të mirë pas humbjes nga Usyk, në revansh do të jetë një boksier ndryshe

LONDËR, 2 TETOR - Boksieri ukrainas Oleksandr Usyk u bë kampioni i parë i padiskutueshëm i botës në peshat e rënda pas fitores me vendim shumice ndaj Tyson Fury në maj të këtij viti. Edhe pse Fury kishte epërsinë ndaj Usykut në mesin e kësaj sfide, ukrainasi bëri një rikthim të frikshëm në raundet e fundit. Gjithsesi, dy boksierët do të përballen sërish në Riad, më 21 dhjetor. Frank Warren, përfaqësues i kompanisë së menaxhimit Top Rank, thotë se Fury tani e di se si ta mposhtë ukrainasin. Duke reflektuar për meçin e parë, ai ka thënë për "Sky Sports": "Në ato raunde të mesit u ndie sikur ai ishte duke u përplasur me të dhe mendoj se ai thjesht u bë pak i dobët dhe i sigurt. Mendoj se Fury mësoi një mësim dhe ishte një mësim i vështirë. Por, gjithashtu, besoj se tjetri do të jetë



më i mirë këtë herë, sepse ka më shumë besim". "Mendoj se personaliteti i tij, siç është ai Fury në ring, është i veçantë. Unë mendoj se ai nuk do t'i marrë gjërat si të mirëqena dhe mendoj se ka marrë një mësim të mirë. Tyson është mjaft filozofik. Ai ndjeu se e fitoi sfidën", ka thënë më

tej Frank Warren. "Revanshi? Mendoj se Tyson duhet të bëjë atë që tregoi në raundet e para. Mendova se ai me të vërtetë do të ndalonte Usyk. Ato gjuajtje të mrekullueshme. Unë thjesht e ndiej Tysonin. Ai është një djalë i zgjuar. Ai e di se çfarë duhet të bëjë", ka deklaruar Warren.

### SHKURT

#### Alonso: Treguam shpirt dhe karakter ndaj Milanit

Bayer Leverkuseni e mposhti Milanin me rezultat 1-0 në ndeshjen e rrethit të dytë në Ligën e Kampionëve. Pas ndeshjes, trajneri Xabi Alonso është shprehur i kënaqur me paraqitjen e bërë dhe me pikët e fituara. "Treguam shpirt dhe karakter. Këto 3 pikë janë shumë të rëndësishme. Në Ligën e Kampionëve duhet të dish të vuash, të luftosh, jo vetëm të luash mirë", u shpreh Alonso.

#### Haaland arrin shifrën më të lartë në tregun e lojtarëve

Erling Haaland vlerësohet tashmë 200 milionë euro, shifër kjo e mbajtur më parë vetëm nga Kylian Mbappe. Është "Transfermarkt", që u vendos vlera lojtarëve në bazë të paraqitjeve të tyre dhe sulmuesi norvegjez ka barazuar rekordin e Mbappes. Asnjë lojtar më parë nuk ka pasur shifër më të lartë. Ylli i Manchester Cityt po spikat dhe këtë sezon si në të kaluarit. Haaland ka shënuar 10 gola në 6 ndeshje të luajtura në Premierë Ligë, ndërsa ka gjetur rrjetën një herë në Ligën e Kampionëve, ku janë luajtur dy takime. Vetëm 24-vjeçar, Haaland ka gjithë vëmendjen. Aktualisht është prej sulmuesve më efektivë.

#### Fonseca: Jemi të zhgënjyer me rezultatin, por të kënaqur me paraqitjen

Trajneri i AC Milan, Paulo Fonseca, është shprehur i kënaqur me paraqitjen e skuadrës së tij edhe përkundër humbjes në përballjen e Ligës së Kampionëve me Bayer Leverkusenin (1-0). "Kjo është ndeshja më e mirë që kemi bërë që në fillim të sezonit. Në veçanti, në fraksionin e dytë krijuam shumë raste. Kjo nuk është e lehtë kundër një ekipi si Leverkusen. Sigurisht, jemi të trishtuar, të zhgënjyer për shkak të rezultatit, por i kënaqur për guximin dhe mënyrën se si e luajtëm këtë ndeshje", theksoi trajneri i Milanit.

#### Flick: Ishte reagimi i duhur pas dy humbjeve

Trajneri i Barcelonës, Hansi Flick, ishte i qartë para ndeshjes kundër Young Boysit, duke kërkuar seriozitet dhe vetëm fitore. Përgjigjja e skuadrës ka qenë e menjëhershme. Barcelona ka fituar me goleadë dhe me shumë lehtësi përballë kampionëve të Zvicrës. Duke folur pas takimit, tekniku gjerman ka vlerësuar paraqitjen e ekipit. "Mendoj se kemi bërë një paraqitje mjaft të mirë dhe kjo për meritë të skuadrës. Na duhej patjetër kjo fitore pas humbjes në ndeshjen e parë në Monaco dhe pas humbjes në La Liga. Reagimi ka qenë i duhur. Kemi bërë gjithçka mirë dhe e kemi konkretizuar dhe me gola", ka thënë Flick.

## Saka: Mjaft më të dytët, këtë sezon dua të fitojmë patjetër diçka

Kapiteni i Arsenalit, Bukayo Saka, shijon momentin me ekipin e tij, që po paraqitet mirë si në kampionat ashtu dhe në Ligën e Kampionëve. "Ne punojmë shumë. Shumicën e ditëve në stërvitje

punojmë në grupe. Për mua dhe për djemtë nuk është rastësi që ne shënojmë në çdo ndeshje", ka thënë Saka. "Këtë sezon kemi shumë uri për trofe. U bënë disa vjet që jemi nënkampionë, ndaj në shpirt

është dëshira e madhe që të fitoj patjetër këtë sezon. Besimi vjen nga puna që bëjmë çdo ditë dhe kjo po më shtyn përpara", ka shtuar Saka. Për punën e tij në mbrojtje, ai shtoi: "Të gjithë lojtarët

sulmues duan të shënojnë dhe të shohin në zonën kundërshtare, por trajneri na ka theksuar shumë nevojën për të bërë edhe anën tjetër të fushës". "Duhet shumë sakrificë dhe disiplinë për t'ia

dalë mbanë, por kjo është ajo që kërkon ekipi. Kur shihni rezultatet, ne kemi shumë ndeshje pa pësuar gol dhe kjo tregon se po marrim shpërblimet për atë punë", u shpreh Saka.



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria -Vlada-Government

MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCES, TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT  
AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRITUR  
AGENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE  
AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION



Nr:1515/1  
Datë: 02.10.2024

## SHPLLJE KONKURSI

**Për regjistrimin e kandidatëve të gjeneratës së pestë për nivelin e 5-të, të kualifikimit “Këshilltarë për Karierrë” në Qendrën e Kompetencës – Prizren**

### 1. Kushtet e përgjithshme për regjistrimin e kandidatëve për regjistrimin e kandidatëve për nivelin 5 sipas Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve (KKK), në Qendrën e Kompetencës në Prizren,

Të drejtë aplikimi kanë:

- 1.1 Kandidatët, Individë që punojnë në sektorin e arsimit dhe punesimit publik dhe privat (mësimdhënës, stafi i qendrave për karrierë, këshilltarët në zyrat e punësimit, kompanitë e rekrutimit, ofruesit e trajnimeve);
- 1.2 Kandidatët të cilët kanë përfunduar shkollimin e mesëm të lartë, shkollimin universitar (niveli 4 i kualifikimit ose më lartë).
- 1.3 Kandidatët të cilët e kanë mbaruar arsimin jashtë Kosovës, obligohen ta bëjnë nostrifikimin, barasvlerësimin e diplomave dhe dëftesave në MASHTI dhe pastaj të konkurrojnë për regjistrim.

### 2. Ofrimi i kualifikimit

Baza e ofrimit të kualifikimit është Qendra e Kompetencës në Prizren si Institucion i akredituar nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve (AKK)

### 3. Përfitimet për kandidatët

Të gjithë kandidatët të cilët me sukses e përfundojnë këtë kualifikim, do të pajisen me certifikatë të nivelit V për “Këshilltarë në karrierë” sipas standardeve të AKK

### 4. Kreditë

Kualifikimi për “Këshilltarë në karrierë” zgjat një 240 orë mësimore – gjashtë javë trajnimi, ku sipas KKK Kualifikimi Kombëtar Profesional (D) me 12 Kredi të Arsimit dhe Aftësimi Profesional.

### 5. PAGESA PËR KUALIFIKIM

Sigurimi i cilësisë së kualifikimit bëhet nga AKK dhe AAAPARR. Të gjithë kandidatët të cilët pranohen për këtë kualifikim janë të obliguar që në afat prej 3 ditëve para se të fillojnë ligjëratat, të paguajnë shumën prej 450 (katër qind e pesëdhjetë) Euro.

### 6. Dokumentet e nevojshme për konkurim

Kandidatët për të konkuruar për regjistrim në kualifikimin e nivelit 5, “Këshilltarë në karrierë” duhet të paraqesin këto dokumente:

- ✓ Aplikacionin e cila merret Qendrën e Kompetencës Prizren;
- ✓ Kopja e letërnjoftimit
- ✓ Diplomën e shkollimit të mesëm të lartë,
- ✓ Diplomë të shkollimit universitar,
- ✓ CV
- ✓ Diploma dhe certifikata tjera
- ✓ I gjithë dokumentacioni duhet të prezantohet si kopje ndërsa origjinalet për verifikim i sjellin vetëm kandidatët të cilët do të pranohen.

### 7. Afati i paraqitjes së dokumenteve, vendi dhe shpallja e rezultateve

Paraqitja e dokumenteve bëhet prej datës 7 tetor 2024 deri 15 tetor 2024

Paraqitja e dokumenteve bëhet në Qendrën e Kompetencës Prizren, Lagjia Dardania pn, 20000 Prizren.

Lista e kandidatëve të pranuar shpallet më 18 tetor 2024

Pagesat bëhet para se të filloj trajnimi me datë 21-22-23-24 tetor 2024

Kthimi i dokumenteve për kandidatët, të cilët nuk janë pranuar do të bëhet pas shpalljes së rezultateve.

Kandidatët e refuzuar në bazë të kriterëve për regjistrim kanë të drejtë që brenda 24 orëve, nga koha e shpalljes së rezultateve të paraqesin ankesë në Qendrën e Kompetencës Prizren

### 8. Kriteret e regjistrimit

Përparësi kanë kandidatët, Individë që punojnë në sektorin e arsimit dhe punesimit publik dhe privat (mësimdhënës, stafi i qendrave për karrierë, këshilltarët në zyrat e punësimit, kompanitë e rekrutimit, ofruesit e trajnimeve);

### 9. Kuotat për pranim të kandidatëve

Do të pranohen gjithsejt 15 kandidat për grup.

### 10. Fillimi i trajnimit

Pjesa e pare e trajnimit fillon 28 tetor – 08 nentor 2024

Pjesa e dytë e trajnimit fillon 18 nentor 2024 – 29 nentor 2024

Pjesa e tretë e trajnimit fillon 09 dhjetor 2024 – 20 dhjetor 2024

## >> SHPLLJE TË VOGLA <<

- Kreshnik Sadiku shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - V sh.f.m.u. “ Bajram Curi “ Krushe e Madhe.

- Haxhi Bytyqi shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII sh.f.m.u. “ Lekë Dukagjini” Prizren, “Berat Gjonovci “ Prizren.

- Valon Kerleshi nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m.t. “Nexhmedin Nixha” Gjakovë.

- Arti Maka nga Juniku shpall të pavlefshme testin e maturës dëftesën e kl. 10.11.12 dhe diplomën e sh.m.m. “Hysni Zajmi” Gjakovë.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.

- Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroj i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

- Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.

**NJOFTIM**

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "Pizzeria Piatto" SH.P.K. me seli në Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nr.b. 812194893 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

**OBAVESTENJE**

Obavestavanje se svi klienti da društvo sa "Pizzeria Piatto" D.O.O. Pristina, donelo odluku o prestani rada sa nr.b. 812194893 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

**ANNOUNCEMENT**

We inform all customers that the limited liability "Pizzeria Piatto" L.L.C. with headquarters Prishtinë, has come to the decision to quit its business: 812194893 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, Kompania "Vëllezërit e Bashkuar" Sh.p.k Zhur, Prizren në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

**DEBAT PUBLIK**

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për zgjerimin e hapësirës për thërrmim dhe seperim të gurit gëlqeror në vendin e quajtur Rezina në Zhur, Prizren.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 20.11.2024 në ora 10:00 në zyrat e administratës së komunës së Prizrenit do të organizohet debat publik nga Kompania "Vëllezërit e Bashkuar" Sh.p.k Zhur, Prizren në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

<https://us04web.zoom.us/j/3551128793?pwd=b252S1MvQmphd1o3bW8vckxadVorQT09>

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për Kompaninë "Vëllezërit e Bashkuar" Sh.p.k Zhur, Prizren për zgjerimin e hapësirës për thërrmim dhe seperim të gurit gëlqeror në vendin e quajtur Rezina në Zhur, Prizren.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin [ynm.komente@rks-gov.net](mailto:ynm.komente@rks-gov.net)

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.





# TRADITË QË NGA

# 1992

